



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

## Shtojca 10

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

*Data 18/04/2024*

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “DRINI A” Shpk, me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen Nationale Lezhe - Shkoder km I, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur/ Mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-99127-03-21-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale per mirembajtjen e godinave te institucioneve dhe godinave arsimore ne administrim te Bashkise Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes-Kuader.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “DRINI A” Shpk, me Nuis J67902505V, me oferte ekonomike 17,319,765 (shtatembedhjete milion e treqind e nentembedhjete mije e shtateqind e gjashtedhjete e pese) Lek pa TVSH,
- 2- Operatori Ekonomik “GJOK SMAKAJ” P/F me Nuis K37811508Q, me oferte ekonomike 19,572,722 (nentembedhjete milion e peseqind e shtatedhjete e dy mije e shtateqind e njezet e dy) Lek pa TVSH,

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

## II. Operatori Ekonomik “GJOK SMAKAJ” P/F me Nuis K37811508Q,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.2.1, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se:

*Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.*

KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te paraqesin vertetimin e xhiros per vitet financiare 2020,2021,2022 sipas kerkeses se pikes 2.2.1 te DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje vertetim per xhiron vjetore duke mospermbushur kete kriter.

Se, dyti nuk ploteson kriterin 2.3.2 deri ne kriterin 2.3.7, te kushteve te veçanta te kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketyre kriterëve.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “GJOK SMAKAJ” P/F, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE Operatori Ekonomik “GJOK SMAKAJ” P/F me Nuis K37811508Q, skualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “DRINI A” Shpk, me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen Nacionale Lezhe - Shkoder km I, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 17,319,765 (shtatembdhjete milion e treqind e nentembdhjete mije e shtateqind e gjashtedhjete e pese) Lek pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**